



Viti i XIV-të i Botimit, Nr. 2,
Dhjetor 2022

VEÇORITË E SHOQËRIVE TREGTARE QË USHTROJNË VEPRIMTARI MEDIATIKE

Brikena Kasmi*

*Albanian University
Fakulteti i Shkencave Shoqërore
AFortiori Legal Counsels

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim të evidentojë rolin e medias në shoqërinë shqiptare si dhe evoluimin e formave të organizimit nga fillesat e deri në ditët e sotme.

Punimi vjen në përputhje me zhvillimet e legjislacionit shqiptar në të drejtën tregtare dhe organizimin e masmedias në Shqipëri.

Ndryshimet historike të vendit tonë por dhe periudhat historike botërore kanë ndikuar në evoluimin e medias. Zhvillimi i masmedias ka njohur etapat e tij kryesore gjatë momenteve historike, si luftërat botërore dhe lëvizjet politike si nevojë e kohës dhe e komunitetit respektiv që kërkon të informohet.

Liria e shprehjes dhe interesi publik kushtëzojnë kufizimet në ushtrimin e biznesit për pronarët e një shoqërie që ushtron aktivitet në fushën e medias. Interesi publik dhe qëllimi tregtar i një pronari qëndrojnë në dy anët e një balance të drejtë në një shoqëri demokratike dhe përbëjnë veçoritë e parimeve dhe rregullave që pronari i një media ndjek. Këto veçori lidhen me administrimin e shoqërisë, riskun tregtar dhe mënyrën e përkthimit në fitime të investimit në fushën e medias

Për qëllime të këtij punimi me forma të masmedias do të kuptohen media e shkruar, media vizive dhe radiofonike. Duke pasur parasysh format e reja të funksionimit të masmedias, shpjegimet dhe trajtimet do të përfshijnë për aq sa mundet dhe median dixhitale.

Fjalë çelës: *media, pronësia, kufizimet, ligjore*

JUDICIAL ELEMENTS OF THE COMMERCIAL COMPANIES THAT OPERATE IN MEDIA SECTOR

Abstract

This study aims to identify the role of media in the Albanian community and the developments of media structures from the initial phase of formation to date.

The study provides the developments in the legislation including the commercial law and the media law in Albania.

The historical transformations in our country as well as the world historical developments have influenced substantially the formation and structures of media organizations. The media organizations has per coursed its own progress steps during each historical phase including world wars and political movements based on the timely needs and the community needs to be informed.

The freedom of expression and the public interest have put its boundaries in the freedom of ownership of the media owners. The public interest and the business goals of media owners as every other owners of a commercial company lay on both sides of a balance in a democratic society. Due to the public interest of media sector, the media ownership has some features wherein the ownership rights are limited based on some rules of organization. These features include limitations to company administration, commercial risk, and the transformation of the commercial activity into profits.

For the purpose of this study, the forms of masmedia shall include but not limited to, the written media, the audiovisual and radiophone media. Considering the new forms of media, such definition shall also include, in as much as it can, the new forms of media technology.

Key words: *media, ownership, limitations, legal*

1. Veçoritë e shërbimit të masmedias

Shërbimi i masmedias është një shërbim që ofrohet nga palët e treta, pra pa ndërhyrje nga shteti duke nënkuptuar të treja format e pushtetit. Si i tillë ai ofrohet nga sektori privat duke iu nënshtruar të gjitha rregullave të vendosura në një vend demokratik. Ndër të drejtat kushtetuese të parashikuara në Kushtetutën tonë, janë liria e shprehjes dhe e drejta për informim. Këto të drejta jo-absolute diktojnë disa nga veçoritë e shërbimit të masmedias të cilat luajnë rol të rëndësishëm në ofrimin e vetë shërbimit si dhe në mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të organeve të masmedias. Këto janë:

- 1.1. *Shërbimii ofrohet në mbrojtje të interesit publik.* Ndërsa doktrina nuk ofron një përkufizim në lidhje me “interesin publik”, rast pas rasti ky (interesi publik) dikton disa nga kufizimet e ushtrimit të veprimtarisë së një shoqërie tregtare që operon në fushën e medias. Interes publik përgjithësisht përfshijnë çështje që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, zbatimin e ligjshmërisë, transporti publik, pastrimi i ujërave të zeza, mbrojtja e konsumatorit, mbledhja e taksave, mbrojtja ndaj fenomeneve si korrupsioni, nepotizmi, etj. Shërbimet e masmedias kanë një rëndësi unike në informimin e publikut, formësimin e opinionit dhe dhënien e aksesit për tu shprehur në çështje që përbëjnë interes publik.
- 1.2. *Shërbimi ofrohet nga sfera private fitimprurëse* (përfshijmë institucionet shtetërore/publike). Media krijohet si biznes në formën e përshtatshme të zgjedhur nga themeluesit (anëtarët, aksionarët, ortakët) dhe të detyruar nga kërkesat ligjore. Legjislacione të ndryshme përcaktojnë që pronarët e masmedias të jenë të organizuar në formën e shoqërive anonime. Kjo siguron një pavarësi më të madhe të drejtuesve, pronarëve dhe ofrimit të shërbimit duke u bazuar në karakteristikat dhe veçoritë e shoqërive anonime (aksionare).
- 1.3. *Shërbimi duhet të funksionojë si një mbikëqyrës* i shtyllave të tjera të pushtetit, pra ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor. Roli i “watchdog” ushtrohet nëpërmjet informimit të publikut, hetimit gazetaresk, kritikizmit dhe analizës.
- 1.4. *Shërbimi duhet të ketë rol informues, argëtues, investigues, edukativ, kulturor, shkencor* sipas vetive të komunitetit të një vendi. Roli i medias në një shoqëri ndërthuret me nevojat e komunitetit për argëtim, informim dhe edukim. Media tradicionale i ushtron të gjitha rolet nëpërmjet një organi duke i plotësuar nevojat me fasha orare brenda 24 orëve. Megjithatë, ndër vite media ka evoluar nga fashat e dedikuara në kanale të dedikuara. Tradicionalisht media dedikon transmetimin, publikimin, shpërndarjen me fasha orare për informimin, argëtimin apo/ dhe edukimin. Dedikimi diktohet nga parashikimet ligjore por siç do të shpjegohet më tutje, ky dedikim i përgjigjet edhe interesimit të publikut.
- 1.5. *Shërbimi duhet të jetë i pavarur* nga çdo ndërhyrje tjetër qoftë dhe të interesave fitimprurës të personave që e drejtojnë këtë shërbim (përfshi aksionarët, drejtorët, pronarët). Pranimi i interesit publik në aktivitetin që ushtron media e bën median të papajtueshëm me çdo interes tjetër qoftë ky edhe një interes legjitim. Balancimi ndërmjet interesit të maksimizimit të fitimit tregtar dhe rolit edukativ, argëtues e informues të medias diktohet nga interesi publik dhe materializohet në parashikime ligjore.

Dy janë sfidat më të mëdha të shërbimit të masmedias dhe interesave fitimprurës të investitorit pronar. **Sfida e parë** lidhet me domosdoshmërinë e shumëllojshmërisë së burimeve të masmedias. Që një masmedia të luajë rolin e saj në dobi të interesit të publikut burimet e informacionit nuk duhet të limitohen dhe duhet të funksionojë sipas parimeve të pluralizmit duke siguruar të drejtën për informim si dhe të drejtën për të dhënë përgjigje nëpërmjet medias. Pluralizmi dhe diversiteti duhet të qëndrojnë në themel të shërbimit të masmedias që gjithsesi fokusin dhe qëllimin parësor e kanë për të informuar dhe shërbyer drejt publikut.

Për këtë legjislacione të ndryshme caktojnë kuota të pasqyrimin televiziv duke përcaktuar nivele të kohës të matshme për lajmet, informacionet, edicionet, debatet politike, publike, çështje të edukimit, punëve publike, argëtimit, sportit, kulturës si dhe çështje të traditës së vendit. Në një shoqëri që zhvillohet shpejt, përcaktimi i diversitetit dhe shumëllojshmërisë, nivelit të teknologjisë së informacionit, zhvillimit të mjeteve dhe modernizimit të tyre duhet të përputhet me kërkesat e organizimit të pronësisë që shpesh

mbeten më tradicionale dhe të shoqëruara me zhvillimet legislative.

Sfida e dytë lidhet me përqendrimin e masmedias dhe shmangies së monopoleve. Një shoqëri demokrate duhet të përcaktojë kritere për të shmangur përqendrimin e masmedias në duart e një pronari apo grupi pronarësh.

Si në çdo aktivitet tjetër publik dhe në shërbimin e masmedias, përfshirja e operatorit privat sjell një vlerë të shtuar në drejtim të përbalimit të sfidës së parë. Liberalizimi i tregut të operatorëve të masmedias është një nevojë e diktuar nga kushtet e tregut dhe zhvillimi njerëzor.

Sfidat përballohen nëpërmjet diversifikimit të formave të themelimit dhe organizimit të ofruesit të shërbimit: privat dhe/apo publik.

2. Liberalizimi i masmedias dhe zhvillimet në vendet perëndimore

Zhvillimi legjislativ në fushën e medias ka njohur ritme të ndryshme në Evropë dhe në Kontinentin Amerikan. Gjatë vitit 1998, shoqëritë mediatike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u përqendruan në fajësimin e gazetarëve për deformim të informimit publik. Disa nga rastet e kësaj periudhe përfshijnë: (i) Rasti i *New Republic* që iu desh të shfaqësohej për shkrimet që një nga gazetarët më të rinj të kësaj shoqërie kishte botuar disa shkrime të fabrikuara (*të sajuara*); (ii) rasti i *Patricia Smith* gazetare pranë *Boston Globe* e cila dha dorëheqjen pas shpikjes së disa personazheve në shkrimet e saj; (iii) hetimet e revistës *Time* në lidhje me ankesat e CNN për përdorimin nga trupat amerikane të gazit nervor ndaj trupave amerikane në Azinë juglindore¹.

Ishte viti 1997, vit në të cili krahasimisht Mbretëria e Bashkuar e Britanisë ishte përfshirë në një debat të madhe për lirinë e medias. “*The Sun*” zotërohej në atë kohë nga Rupert Murdoch dhe partitë laburiste dhe konservatore ishin në prag fushate elektorale. Pasqyrimin në media të disa skandaleve seksuale të njërit kamp bënë që kampi tjetër të premtonte miratimin e një legjislacioni më favorizues për masmedian. Debate për lirinë e medias kishte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kryesisht në lidhje me pasqyrimin e artikujve të zhvillimeve financiare dhe të arenës ndërkombëtare në vend dhe pavarësinë e gazetarëve në profesionalizmin e tyre të *CNN* dhe *New York Times*.

Shoqëritë e masmedias duhet të garantojnë zbatimin e pluralizmit nga *jashtë* dhe pluralizmit të *brendshëm* të organeve të masmedias. Pluralizmi i *jashtëm* lidhet me parashikimet ligjore mbi tregtimin e aksioneve, pjesëmarrjen në shoqëri të tjera, marrëdhëniet tregtare në lidhje me shtëpitë botuese, përqindja e mbulimit, pasqyrimi tematik. Garantimi i pluralizmit të *jashtëm* bëhet nga organet mbikëqyrëse.

Pluralizmi i *brendshëm* lidhet me marrëdhëniet që ka gazetari si profesionist që ushtron në praktikë aktivitetin e masmedias dhe organeve të shoqërisë pronare të medias. Garantimi i pluralizmit të *brendshëm* bëhet nëpërmjet miratimit të rregulloreve², statuteve me parashikime të pavarësisë, kodit të etikës dhe ka më shumë një natyrë vetërregulluese brenda vetë profesionit.

Mekanizma të tjerë kontrolli dhe mbikëqyrje mundet të jenë struktura të krijuara nga vetë media si pjesë e shoqërisë civile. Standardizimi i vetërregullimit mediatik synon të korrigjojë çdo lloj abuzimi mediatik, pavarësisht qëllimit të përdorur në të gjitha rastet ekstreme dhe të mbrojtë median dhe shoqërinë shqiptare. Një nga format është autorizimi i një shoqërie të pavarur nga komuniteti mediatik, jo-fitimprurës, apo shoqërive të konsulencës, për monitorimin nëpërmjet analizave, vlerësimeve, të dhënave statistikore dhe raportimeve shpjeguese jo vetëm të çështjeve konkrete, por të situatës konkrete, përbërjes demografike të popullsisë, tipareve dalluese të shoqërisë, traditës si dhe nivelit të emancipimit të shoqërisë mediatike. Metodologjia e ndjekur ndryshon nga vendi në vend. Deri më tani njihen 4 mënyra të llogaritjes së përqendrimin mediatik nga shoqëritë në një vend të caktuar. Ato janë:

1. Raportet e përqendrimin të cilat krahasojnë të ardhurat e një numri të caktuar shoqërisht në atë industri psh 8 të parat me të ardhurat e të gjithë shoqërive në industrinë e medias. Nëse fitimet e 4 të

1 Si më sipër

2 Ligji 8410 i ndryshon parashikimet detyrime për paraqitjen e listës së aksionerëve, drejtorëve apo administratorëve si dhe CV të tyre në rastet e procedurës së licencimit.

Shih dhe nenet 50-63 të ligjit nr. 97 të vitit 2013 mbi transmetimet audio vizive në Republikën e Shqipërisë

2. parave janë më shumë se 50% të të gjithë industrisë ose fitimet e këtyre të 8-tave janë më shumë se 75% të të ardhurave të të gjitha shoqërive që operojnë në këtë vend, atëherë konsiderohet se përqendrimi është i lartë.
3. Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) që përdoret nga Departamenti anti trust i Shteteve të Bashkuara duke krahasuar sasinë e aksioneve të shoqërisë përkatëse me atë të aksioneve të tregut të sektorit apo industrisë së medias.
4. Indeksi Divers. Kjo metodologji mat konsumin e informacionit nga media sipas sondazheve për burimin e informacionit, kohën më të parë të transmetimit, shpërndarjen dhe vlerën e kapitalit të kësaj shoqërie në raport me kapitalin e përgjithshëm të industrisë.
5. Grafiku Lorenz i cili parashikon një vlerë teorike të kapitalit të një shoqërie dhe e krahason atë me vlerën aktuale që ka kjo shoqëri mediatike në një treg të caktuar.
6. Politikat publike të cilat zbatohen mbi baza rastësore dhe zakonisht matin përqendrimin e pronësisë mediatike **nëpërmjet organeve mbikëqyrëse.**

Sigurisht që ka dhe metoda të tjera informale të cilat vlerësojnë përqendrimin në treg. Legjislacioni në fuqi në vendin tonë lejon për aplikimin e metodës së politikave publike duke garantuar një përjasje të vlerës së aksioneve në një treg, kërkesave për licencimin, raportit mes mbulimit të territorit dhe fitimeve të asaj shoqërie, burimet e informacionit dhe programeve televizive me kostot e shpërndarjes.

Në Evropë, legjislacioni dhe rregullimet ligjore të fushës së masmedias kanë njohur etapat e tyre më të rëndësishme gjatë fillim viteve 90 si dhe vitet 1998 – 2003. Pas viteve 2000 shihet një interesim i vazhdueshëm deri në ditët e sotme të përcaktimeve nga autoritete që kanë kompetencë nxjerrjen e akteve detyruese për shtetet anëtare. Në kuadrin e legjislacionit parësor që është detyrues për vendet anëtare por dhe legjislacionit dytësor që udhëzon e sugjeron për rregullimin e një fushe të veçantë, paraqiten rregullimet si vijon për media.

A. Legjislacioni parësor i Bashkimit Evropian në lidhje me mediat.

Parimet kryesore të funksionimit dhe të organizimit të lirisë së medias në vendet e Bashkimit Evropian (Evropa) jepen në legjislacionin parësor. Konventat e ndryshme, kartat e të drejtave të njeriut japin parimet bazë që përmbledhen në këto drejtime:

- Garantimi i të drejtës së medias dhe lirisë së shtypit
- Caktimi i kufijve dhe limiteve të ushtrimit të aktivitetit tregtar (biznesit) të pronarëve të medias me qëllim përcaktimin e kufijve të ndikimit të pronësisë (outlet) në lirinë editoriale
- Ushtrimi i lirisë informative dhe mbrojtja e burimeve

Neni 11, pika 2 e Kartës së të drejtave themelore të Bashkimit Evropian, miratuar më 7 dhjetor 2000, sanksionon lirinë dhe pluralizmin e medias.

Protokolli nr.29 “Për sistemin e radiotransmetimit publik në Vendet anëtare”, i aneksuar në Traktatin mbi Bashkimin evropian (7 shkurt 1992) dhe në Traktatin mbi funksionimin e Bashkimit Evropian (ose Traktati i Romës, 25 mars 1957) përcakton kompetencat respektive të Bashkimit Evropian dhe Shteteve anëtare, në fushën e shërbimit publik të radiotransmetimit.

B. Legjislacioni dytësor i Bashkimit Evropian në lidhje me mediat.

Në kuadrin e legjislacionit dytësor, përmenden një sërë rekomandimesh dhe rezolutash të cilat si kategori do të ndahen në:

- Respektimin e të drejtës së medias³
- Parashikimet rregullatore të organeve të medias⁴.

3 Rekomandimi 1897 (2010); Rekomandimi nr. R (99); Rekomandimi nr. R (94) 13

4 Rekomandimi nr. R (2000) 23; Rekomandimi nr. R (96) 10; Rekomandimi nr. 2006/952/CE, datë 20 dhjetor 2006; Rekomandimi i Komisionit evropian, nr. 2009/625/CE, datë 20 gusht 2009; Direktiva e Televizionit pa Kufinj, kjo direktivë përbën bazën e politikës audiovizuale të Bashkimit Evropian dhe është ndryshuar nga: Direktiva e Parlamentit evropian nr. 97/36/CE, datë 30 qershor 1997 “Për ndryshimin e direktivës nr.89/552/CEE, datë 3 tetor 1989 Direktiva e Parlamentit evropian nr.2007/65/CE, datë 11 dhjetor 2007 “Për ndryshimin e direktivës nr.89/552/CEE”. e quajtur ndryshe Direktiva e “Shërbimeve të medias audiovizuale pa kufinj” Direktiva e Parlamentit evropian nr. 97/36/CE, datë 30 qershor 1997 “Për ndryshimin e direktivës nr.89/552/CEE, datë 3 tetor 1989.

- Rregullat e shoqërive tregtare⁵ që lidhen me funksionimin e shoqërive të cilat kanë aksione kontrolluese/drejtuese në një organ mediatik.
- Direktiva lidhur me përmirësimin e legjislacionit lidhur me rregullimet e përmendura në kategorinë e parë dhe të dytë si vijon këtu më sipër, si dhe parashikimet⁶ që lidhen me dispozitat të së drejtës civile, publike dhe penale për të drejtën për informim, shpifjen, fyerjen, të dhënat personale si dhe mjetet mbrojtëse (hetimore).
- Sugjerime⁷, orientime dhe rekomandime për vendet anëtare dhe më gjerë (me status të ndryshëm si vendet jo anëtare, vendet e treta dhe vendet me status kandidat) në lidhje me çështje apo fenomene të ndodhura. Këtu bëjnë pjesë, rekomandimet që lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e gazetarisë investigative, mbrojtjen e medias ndaj akteve fenomeneve terroriste, kufizimi i pushtetit të shteteve dhe hapja e tyre ndaj medias si dhe forcimin e transparencës.

Legjislacioni dytësor sjell dhe rregullime të nevojshme për vendet anëtare në lidhje me rolin dhe funksionimin e medias dhe objektivat e saj bazë. Kështu edukimi në media: përkufizohet si kapaciteti për të patur akses në media, për të kuptuar dhe vlerësuar aspekte të ndryshme të mediave dhe të përmbajtjes së tyre⁸.

E drejta e medias gjithashtu parashikohet si e përcaktuar brenda disa limiteve⁹ dhe që këto limite janë të nevojshme për shtetet për të ndërhyrë në një vend demokratik bazuar në një bazë ligjore të fortë dhe solide, të garantuar më parë për mbrojtjen e interesit publik, në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

3. Zhvillimet ligjore të ofruesit të shërbimit në Shqipëri

Liberalizimi i masmedias në këto vende, i dha mundësi privatizimit të organeve të masmedias dhe krijimit të masmedias në formën e personave fizikë e juridikë. Regjistrimi si person juridik në organet e përcaktuara nga ligji (gjykatat) ka ekzistuar kryesisht për median e shkruar, dhe në raste të veçanta dhe për median vizive.

Ligji¹⁰ 8221 në vitin 1997 ishte i pari ligj në pluralizmin shqiptar që i dedikohet pluralizmit të medias publike dhe private duke vënë rregulla të qarta për mënyrën e funksionimit. Ky ligj rregullon veprimtarinë e radios dhe televizionit publik e privat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji parashikon për herë të parë në mënyrë të moderuar për kohën, rregulla të caktuara për dhënien e licencës. Neni 19 parashikonte disa detyrime në lidhje me organizimin e shoqërisë që ushtron aktivitetin e masmedias dhe që aplikon për licencën e radios apo televizionit.

Detyrimi themelor dhe që përqaste të gjitha lëvizjet në arenën ndërkombëtare në atë kohë ishin:

- Llojin e aksioneve të një shoqërie (nominative) me emër të regjistruar. Për efekt të transparencës së nevojshme në listën e aksionarëve të operatorëve radiotelevizivë nuk lejohen aksionet për prurësin.

5 Rekomandimi nr.98/560/CE, datë 24 shtator 1998; Direktiva nr. 2000/31/CE, datë 8 qershor 2000

6 Direktiva e Këshillit evropian nr.89/552/CEE, datë 3 tetor 1989

7 Shënimi i Bardhë (Ëhite paper) mbi një politikë komunikimi evropiane (COM[2006]374

Rezolutë e parlamentit evropian mbi rrezikun e shkeljes, në EU dhe vecanërisht në Itali të lirrisë së shprehjes dhe të drejtës për informim (neni 11(2) i Kartës së Drejtave themelore) (2003/2237).

Rezolutë e parlamentit Evropian mbi zbatimin e neneve 4 dhe 5 të Direktivës 89/552/EEC (“Televizioni pa kufij”), ndryshuar nga Direktiva 97/36/EC, për periudhën 2001_2002, A6-0202/2005

Rezoluta e Këshillit evropian nr.94/C 181/02, datë 27 qershor 1994, “Për politikën komunitare në fushën e radiotransmetimit televiziv numeric”.

Rezoluta e Këshillit evropian nr. 95/C 247/01, datë 4 prill 1995, “Për kulturën dhe shërbimet “multimediale””.

8 Vendimi i Komisionit evropian nr. 2009/336/CE, datë 20 prill 2009 “Për krijimin e Agjencisë ekzekutive për menaxhimin e politikës komunitare në fushën e edukimit audiovizual dhe të kulturës”

Vendimi i Parlamentit dhe Këshillit evropian nr.1041/2009/CE, datë 21 tetor 2009 “Për hartimin e një programi bashkëpunimi audiovizual me profesionistët e vendeve të treta”.

9 Doc. 11305 25 June 2007 Toëards decriminalisation of defamation

10 Ligji Nr. 8221, datë 14.5.1997 Për radion dhe televizionin public e privat në Republikën e Shqipërisë

- Shoqëritë kanë në objektin e tyre vetëm aktivitete radiotelevizive. Ky ligj dhe ligjet e tjera pasuese
- përcaktojnë ekskluzivitetin në ofrimin e shërbimit të shoqërisë aksionare. Ekskluziviteti është një nga treguesit e garantimit ligjor të shmangies së ndikimit të medias nga konkurrenca tregtare.
- Detyrimi për aksionarët të mbajnë aksione deri në 25%. Shmangia e përqendrimit të aksioneve është një nga kërkesat kryesore të pluralizmit mediatik. Pluralizmi mediatik shpesh është konsideruar nga studiues të ndryshëm si pluralizmi i pronarëve të medias.
- të kapitalit në shoqëri. Ky limit ishte 20% në rastin e personave të huaj dhe ndalohej pjesëmarrja në një shoqëri më shumë se 15 % në rastet se pronari i aksioneve kishte kontroll direkt apo në mënyrë të tërthorë në një shoqëri tjetër televizive.

Një nga kërkesat e tjera detyruese për zbatim ishte dhe marrëdhënia me shtëpitë botuese të gazetave të cilat kishin tirazh shitje në të gjithë vendin mbi 10% të tirazhit të përgjithshëm. Shoqëritë që zotëronin kontrollin e këtyre lloj ndërmarrjeve botuese nuk legjitimoheshin për të ushtruar aktivitet radioteleviziv. Gjithashtu, limite dhe parashikime rigide kishte dhe për kapitalin e shoqërisë aksionare. Për transmetime radiotelevizive në shkallë kombëtare, licenca jepet vetëm për subjekte të cilat kanë kapital të vërtetuar në masën 20 milionë lekë për transmetim radiofonik, dhe 100 milionë lekë për transmetim televiziv.

Parashikimet ligjore në ligjin e vitit 1997 erdhën si një risi dhe konfirmim i qëndrimit të shtetit drejt vendosjes së treguesve të demokracisë. Deri më tani në shkallë botërore media kishte një dekadë që kishte hyrë në një debat të thellë diskutimi në lidhje me marrëdhënien e biznesit të medias me masmedian vetë, punësimin e stafit, përqendrimin e masmedias në duart e një grupimi. Të gjitha këto debate kishin një synim të vetëm të konsolidonin pavarësinë e medias në funksionimin e saj. Lëvizja nga masmedia me burime financimi publike drejt atyre private, kishte sjellë me vete dhe sfidën e kontrollit apo përdorimit të masmedias si një mjet të fuqishëm presioni ndaj pushteteve të tjera. Vënia nën kontrollin e kërkesave ligjore mundëson shmangien e ndikimit të masmedias si një shërbim në interes të publikut nga interesat e pushteteve të tjera. Ndikimi ndaj politikanëve, kërkesave të biznesit tregtar apo individëve të fuqishëm kishte një tendencë në rritje në këtë periudhë në vendet e zhvilluara perëndimore.

Deri më tani në Shqipëri si dhe në shumë vende të Evropës juglindore, organet e masmedias kanë vepruar në mënyrë të lirë të orientuar nga kërkesat e tregut vendas. Ky vit (1997) njihet si viti i rregullimit ligjor të themelimit të organeve të masmedias që përkrah tendencat botërore në kuadër të liberalizimit të masmedias.

Përveç kërkesave të formës apo organizimit të shoqërisë (aksionare) të masmedias, ligji vendosi për herë të parë dhe disa kërkesa në lidhje me transparencën financiare. Neni 46 parashikonte se detyrimin për hartimin e bilanceve vjetore me të dhëna për programet e transmetuara, çmimet e tyre kur ato janë blerë ose shuma e harxhuar kur ato janë programe origjinale, të dhëna për reklamën e transmetuar ose veprimtari të tjera dhe të ardhurat përkatëse, sponsorizimet, si dhe lista e financuesve apo dhuruesve me shumën përkatëse dhe çdo shpërblim tjetër në favor të subjektit radioteleviziv publik ose privat.

Këto kërkesa mbetën të pandryshuara dhe u rikonfirmuan me ligjin nr. 8410 datë 30.9.1998. Ky ligj rregullon veprimtarinë e radios dhe televizionit publik e privat në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kështu, ligji 8410¹¹ së bashku me parashikimet parimore sikurse janë sigurimi i pavarësisë editoriale dhe respektimi i lirisë së veprimtarisë radio-televizive sjell dhe parashikime në lidhje me organizimin e shoqërisë së medias. nuk Struktura e ligjit 8410 dhe ligjit 8221 nuk ndryshuan. Ato që ndryshuan janë disa parashikime në lidhje me:

- përqindjen që aksionet e një aksionari duhet të zënë në kapitalin e shoqërisë. Vlera 25% rritet në 40%. Duke qenë se ky ligj miratohet menjëherë pas vitit elektorale, është rasti të vërehet nëse dhe këtu jemi përpara situatës “Murdoch”.
- Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri televizive ose radioje kombëtare, nuk lejohet të jetë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrës në një shoqëri të dytë televizive ose radioje

11 Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 Për radion dhe televizionin public e privat në Republikën e Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 8655 date 31.07.2000, me ligjin nr. 8794 date 10.05.2001, me ligjin nr.9016 date 20.2.2003, me ligjin nr.9124 date 29.07.2003, me ligjin 9531 date 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, date 13.01.2007)

kombëtare, si dhe nuk i lejohet të marrë licencë për transmetim televiziv ose radioje vendore.

Duke qenë se kërkesat e tjera mbetën të pandryshuara¹², si vijon po radhisim vetëm kërkesat e riformuluara në licencimin e subjekteve për licencë radiotelevizive kombëtare apo lokale. Ligji 8410 ka pësuar disa ndryshime gjatë viteve dhe aktualisht ishte legjislacioni i posaçëm që pasqyron marrëdhëniet e shërbimit (objektit të shoqërisë) me të drejtat e aksionarëve.

Ky ligj parashikonte gjithashtu se:

- Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të asamblesë së shoqërisë anonime, me objekt të vetëm veprimtarinë për transmetime televizive ose radio, janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e mbajtësve të aksioneve.
- Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri radio ose televizive, nuk lejohet që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit, njësisive të pushtetit vendor ose shoqërive me kapital shtetëror, si dhe në procesin e privatizimit të pronës publike.
- Gjatë licencimit, subjekti paraqet dhe listën e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca; listën emërore të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe curriculum vitae të tyre. (neni 23)
- Ligji përcakton dhe disa kritere në lidhje me organizimin e brendshëm të shoqërisë si dhe vë disa kërkesa tej kërkesave të organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare. Të tilla janë Numri minimal i anëtarëve të Bordit për çdo subjekt të licencuar;

Organizimi, funksionimi dhe financimi i Radiotelevizionit publik Shqiptar parashikohen në ligjin 8410 të ndryshuar. Ligji parashikon se Veprimtaria e Radiotelevizionit publik Shqiptar rregullohet me këtë ligj. Neni 86 i këtij ligji parashikon se Organet drejtuese të RTSH-së janë a) Këshilli Drejtues, b) Drejtori i përgjithshëm, c) Bordi i Administrimit. Ligji¹³ parashikon dhe burimet e financimit sikurse janë taksa mbi aparatën marrës për programet e RTSH-së, kontratat me palë të treta, shërbime të tjera programesh; botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet; veprimtaritë koncertale dhe shfaqjet publike; reklamat dhe publikimi i mesazheve të tjera të paguara; sponsorizimet dhe dhurimet; shitja e programeve të RTSH-së; dhe buxheti i shtetit.

Ligji 8410¹⁴ për herë të parë garantonte pluralizmin e *jashtëm*. Kështu ai parashikonte se për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë krijohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), i cili është organizëm i pavarur, që vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Ligji parashikon se Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit zgjidhet nga radhët e personaliteteve në fushat e politologjisë, drejtësisë, masmedias, sociologjisë apo shkencave të tjera humanitare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë radiotelevizive, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtar i KKRT-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidaturave të propozuara nga subjektet përkatëse si:

- a. nga shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
- b. nga shoqatat e medias së shkruar
- c. nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
- d. nga profesorati i së drejtës, shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë
- e. nga subjektet parlamentare;
- f. nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike.

Ky parashikim synon të garantojë pavarësinë e këtij organi në mbikëqyrjen e pluralizmit të masmedias.

12 Shih parashikimet e ligjit 8221

13 Neni 115 i ligjit 8410 i ndryshuar

14 Neni 6 i ligjit 8410 i ndryshuar, shih dhe parashikimet ligjit nr. 97 të vitit 2013 mbi transmetimet audio vizive në Republikën e Shqipërisë

Vlen të theksohet se ligji për shoqëritë tregtare¹⁵ parashikon se mënyra e organizimit dhe funksionimit ndjek rregullat e përcaktuara në ligjin për shoqëritë tregtare pavarësisht nëse këto shoqëri janë me kapital privat apo shtetëror (kontrollohen nga shteti apo kanë një marrëdhënie mëmë – bija me shtetin) duke përfshirë organet drejtuese, financimin dhe ndarjen e fitimit.

Aktualisht, radiotelevizioni publik shqiptar i nënshtrohet rregullave të ligjit të posaçëm duke i dhënë përparësi *lex specialis* ndaj *lex generalis* tregtar. Ligji parashikon dhe detyrimin e miratimit të rregullave të statutit të radio televizionit, parashikon rregullat e veçanta në lidhje me kohën televizive si dhe parashikime në lidhje me ushtrimin e aktivitetit radioteleviziv.

Disa nga dallimet kryesore që përmban legjislacioni shqiptar për operatorët publikë, në këtë rast radio televizioni shqiptar, dhe atyre privatë janë:

- Mënyra e organizimit dhe funksionimi i organeve drejtuese (shih më lart)
- Ndarja e fitimit
- Licencimi (për subjektet private kërkohet licencimi)
- Mbulimi i territorit për mbajtësit e licencës kombëtare dhe radiotelevizionit. Mbajtësi i licencës për transmetim radioteleviziv kombëtar duhet të realizojë mbulimin e deri në 90¹⁶ për qind të territorit dhe jo më pak se 90 për qind të popullsisë. Vlen të theksohet se pavarësisht se ligji ka hyrë në fuqi në vitin 1998, kjo kërkesë për subjektet private ka filluar të aplikohet pas 6 vjetësh, pra që nga viti 2004. Detyrimi ligjor për radiotelevizionin është të paktën njëri nga programet e RTSH-së duhet të mbulojë 99¹⁷ për qind të popullsisë.
- Ndalimi i pjesëmarrjes në tenderët publikë¹⁸.
- Kohëzgjatja e transmetimit për programet private. Transmetimet e programeve në radio ose televizion privat lokal detyrimisht duhet të kenë jo më pak se 6 orë në ditë transmetime në radio dhe jo më pak se 4 orë në ditë transmetime në televizion. Transmetimet e programeve në radio ose televizion privat në shkallë kombëtare janë jo më pak se 10 orë në ditë transmetime në radio dhe jo më pak se 6 orë në ditë transmetime në televizion. Ky detyrim nuk parashikohet në mënyrë të shprehur për radiotelevizionin publik.
- Funksionimi i degëve për shoqëritë aksionare private në territorin e vendit sipas të drejtës tregtare, ndërsa parashikohet se RTSH-ja organizohet me qendra rajonale radiotelevizive.

Dallimet kryesore ndërmjet operatorëve publikë dhe atyre privatë lidhet dhe me rreziqet që i kanosen secilit organ të medias. Për operatorët privat¹⁹, rreziku kryesor është përqendrimi, ndërsa për operatorët publik është ndërhyrja nga pushteti politik.

4. Karakteristikat e themelimit dhe organizimit të ofruesit të shërbimit

Deri në vitet 1990 Bashkimi Evropian u përfshi në debatet në lidhje me privatizimin e shoqërive shtetërore në disa fusha me interes publik të veçantë. Në listën e fushave me interes të veçantë përfshihej dhe media publike. Shqipëria sikurse dhe vendet e tjera ish-komuniste shtetëzoi organet e informimit publik. Në këtë mënyrë për më shumë se 50 vjet për Shqipërinë, informacioni jepej në një mënyrë të kontrolluar nga pushteti qendror duke e shndërruar lirinë editoriale në një mjet/ mekanizëm të përhapjes së propagandë politike për masën e gjerë.

Ligji²⁰ i ri nr. 97 datë 4.3.2013 “Për media audiovizive në Republikën e Shqipërisë” parashikon ndarjen

15 Shih nenet 213 e vijues të ligjit 9901

16 Ligji parashikon mbulimin e 70 për qind të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh ky mbulim duhet të arrijë të përfshijë 90% të territorit.

17 Brenda 5 vjetësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

18 Ligji parashikon se Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri radio ose televizive, nuk lejohet që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit, njësisive të pushtetit vendor ose shoqërive me kapital shtetëror, si dhe në procesin e privatizimit të pronës publike.

19 Shih më shumë në Commission staff working Document, Media pluralism in the Member States of the European Union {SEC(2007) 32}

20 Neni 31

në forma të shërbimeve mediatike. Ligji i ri, konfirmon rolin dhe rëndësinë që kanë shërbimet mediatike që reflektohet në përshtatjen e formës ligjore të licencimit dhe të pronësisë mediatike. Aktualisht me parashikimet e reja ligjore vihet re një tolerancë në drejtim të formës së organizimit të shoqërive që ofrojnë shërbime mediatike. Duke përjashtuar shoqëritë që veprojnë mbi bazën e një licence kombëtare të shërbimeve mediatike audio dhe audio vizive, të cilat duhet të jenë në formë e regjistruar aksionare, shërbimet lokale mundet të garantohen dhe nga shoqëri apo persona fizikë.

Si vijon do të detajohet gjerësisht hapësirat e reja ligjore dhe forma e ushtrimit të veprimtarisë.

Llojet e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive janë:

- sipas formës së pronësisë
- sipas mënyrës së shpërndarjes
- sipas mbulimit të territorit

Sipas formës së pronësisë mbi kapitalin, shërbimet mediatike kategorizohen në shërbime publike, private, tregtare ose jo tregtare. Për herë të parë në vendin tonë vihen përcaktime të qarta në lidhje me juridiksionin që do të zbatohet për shoqëritë që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe /ose audiovizive.

Ligji për mediat audiovizive **përcakton**²¹ kriteret e juridiksionit shqiptar duke e lidhur ushtrimin e veprimtarisë audio dhe/ose audiovizive me shtrirjen/ vendndodhjen e qendrës së shoqërisë pronare.

Nga ana tjetër ligji aktual i ndan shoqëritë që ofrojnë shërbimet mediatike²² **në:**

- persona fizikë dhe
- persona juridikë

Përcaktimi i formës pronësore në private, publike përshtat ushtrimin e biznesit të shoqërive mediatike me parashikimet e ligjit për shoqëritë tregtare dhe kodit civil.

Kodi civil²³ **vë përcaktim në lidhje me personat fizikë apo juridikë privatë apo publikë.** Persona juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Ligji parashikon se institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen. Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Sa shihet nga përcaktimet e reja të ligjit për shërbimet mediatike, forma pronësore ndahet dhe në shoqëri tregtare ose jo-tregtare.

Tregtari dhe jo-tregtari karakterizohen nga regjistrimi i tyre në organet tatimore për efekt të ndjekjes së qëllimit të tyre ekonomik. Sipas ligjit për shoqëritë tregtare: “Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm”.

Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status. Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agro-biznes). Personi fizik, veprimtaria ekonomike e të cilit, për shkak të vëllimit të tij, nuk kërkon një organizim të zakonshëm tregtar (tregtar i vogël), nuk vlerësohet tregtar e nuk i nënshtrohet ligjit për shoqëritë tregtare²⁴.

Duke qenë se ligji i posaçëm në rastin tonë ligji për shërbimet mediatike nuk vë detyrime të përcaktuara përveçse rastit të shërbimeve mbi bazën e një licence kombëtare dhe rajonale mundet që shërbimet e tjera

21 Neni 30

22 Neni 3 përkufizimet: Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

23 Nenet 24, 25, 26 të Kodit civil

24 Neni 3 I ligjit 9901 datë 14.4.2008 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

të ofrohen nga një person fizik jo – tregtar.

Dy detyrimet ligjore²⁵ në lidhje me shërbimet mediatike për shoqëritë e tyre janë:

- forma aksionare për ato që ushtrojnë veprimtarinë me licencë kombëtare të transmetimit audio dhe licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë
- Dhe ato që kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive²⁶. Ky detyrim vlen për licencat kombëtare dhe rajonale të shërbime audio dhe audio vizive.

Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri²⁷, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare e transmetimit audioviziv, janë nominative.

Gjithashtu në vijim të risive që sjell ligji i ri për nga pikëpamja e formës vlen të përmenden dhe disa parashikime lidhur me pozitën e Radios dhe televizionit publik. Pavarësisht natyrës publike që ka radio televizioni publik sipas shërbimeve dhe financimit (buxhetit të shtetit dhe të tjera), ligjit lehtëson marrëdhëniet e biznesit të tij duke parashikuar²⁸ se:

“RTSH-ja mund të hyjë në marrëdhënie huaje, kontrate shërbimi, transaksione apo sipërmarrjeje të përbashkët me subjekte të tjera, kur këto marrëdhënie ngrihen mbi bazën e pronave të veta, në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon këto veprimtari.”

Gjithashtu për të garantuar pronësinë në asetet e paluajtshme të radio dhe televizionit për nga natyra e qëllimit që ndjek, ligji parashikon²⁹ se:

“Pasuritë e paluajtshme të RTSH-së regjistrohen si prona të paluajtshme publike dhe administrohen vetëm nga RTSH-ja për përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në këtë ligj.”

Ligji parashikon rregulla të qarta në lidhje me aplikimin e marrjes së licencave të transmetimit si kombëtare dhe lokale duke garantuar kështu konkurrencën e lirë dhe profesionalizmin në drejtim të dhënies së informacionit dhe edukimit mediatik për publikun në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëritë e shërbimit mediatik³⁰ (OSHMA) në Shqipëri klasifikohen sipas mënyrës së shpërndarjes në tokësore, satelitore, me kabllo, TV në internet, ose në ndonjë formë tjetër; ndërsa sipas mbulimit të territorit ato ndahen në kombëtarë, rajonalë, lokalë ose ndërkuftarë.

Këto parashikime apo sikurse njihen kryesisht si dispozita me referencë të bardhë, jo direkte tregojnë se legjislatori në kohën e hartimit të ligjit është i vetëdijshëm për forma të reja të panjohura në këtë kohë të transmetimeve apo ofrimit të shërbimit mediatik audio apo audiovizive.

Ligji³¹ për shërbimet mediatike përcakton disa lloje shërbimesh sipas licencave përkatëse. Të tilla janë:

- licencë shërbimi programi audio, për ofrimin e një shërbimi programi audio
- licencë shërbimi programi audioviziv, për ofrimin e një shërbimi programi audioviziv;
- licencë transmetimi audio, e cila përbëhet nga:(licencë shërbimi programi audio; për ndërtimin e operimin e rrjetit, analog ose numerik; licencë transmetimi audioviziv, shërbimi programi audioviziv, për ndërtimin e operimin e rrjetit.
- Licencat për ndërtimin e rrjeteve numerike
- Autorizimet e shërbimit të programit audio dhe autorizimet³² e shërbimit të programit audioviziv: satelitor, kabllor, *on line*, ofrues shërbimi, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

25 Neni 62 Rregullimi i pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore të ligjit 97 datë 4.3.2013

26 Neni 62 Rregullimi i pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore të ligjit 97 datë 4.3.2013

27 Neni 62 Rregullimi i pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore të ligjit 97 datë 4.3.2013

28 Neni 113 I ligjit 97 datë 4.3.2013

29 Neni 114 i ligjit 97 datë 4.3.2013

30 ligjit 97 datë 4.3.2013

31 Neni 55

32 Neni 128 Kualifikimi i OSHMA-ve për mbulimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun Dy ose më shumë

OSHMA mund të lidhin kontratë ose marrëveshje për të realizuar së bashku mbulimin e përgjithshëm të një ngjarjeje me rëndësi. Në një rast të tillë këta OSHMA konsiderohen së bashku si një OSHMA i kualifikuar në lidhje me mbulimin e përgjithshëm.

5. Konkluzione

Megjithatë që pavarësia editoriale të ekzistojë dhe të zbatohet në praktikë duhet që ky standard apo këto rregulla të përcaktohen në akte të shkruara. Parashikimet ligjore në lidhje me kufizimet e tjetërsimit të aksioneve të shoqërisë, marrëdhëniet në lidhje me organet publike, kohëzgjatjen e transmetimeve, etj mundësojnë garantimin në dukje të pavarësisë editoriale.

Funksionimi dhe garantimi i plotë i lirisë së medias garantohet nga organet mbikëqyrëse të shoqërive të masmedias. Sikurse dhe në sektorë të tjerë të posaçëm si për shembull fushat e sigurimeve, bankare dhe shoqëritë e masmedias janë subjekt i mbikëqyrjes së aktivitetit të tyre përveç mbikëqyrjes dhe kontrollit të aktivitetit tregtar. Dallimi kryesor i shoqërive të masmedias është se ata përmbushin në vetvete një interes publik dhe gjithashtu synojnë të garantojnë funksionimin e një pushteti të katërt të shtetit. Në këtë rast, është e këshillueshme që mbikëqyrja të realizohet nga vetë pushteti. Disa³³ kanë rregulla në ligjet e tyre për konkurrencën, ndërsa disa të tjerë në ligje të veçanta. Duke qenë se qëllimi i shmangies së monopoleve dhe garantimit të konkurrencës nga njëri sektor në tjetrin ka karakteristikat e tij, për shoqëritë e masmedias vende të ndryshme kanë miratuar legjislacione të ndryshme.

Aktualisht në vendin tonë është përkrahur tendenca më e fortë e garantimit të lirisë së medias dhe shmangies së monopoleve në treg të shoqërive të masmedias. Shoqëritë e masmedias duhet të garantojnë zbatimin e pluralizmit nga *jashtë* dhe pluralizmit të *brendshëm* të organeve të masmedias.

Në kuadër të përqendrimit dhe shmangies së ndikimit nga biznesi tregtar disa nga rreziqet e tjera që paraqiten për shkeljen e të lirisë së medias janë:

- Përqendrimi i aksioneve në një dorë të vetme
- Presioni ndaj të bërit biznes, krijimi i opinionit publik për një produkt apo shërbim të lidhur me biznesin dhe orientimi i çrregullt i publikut
- Presioni ndaj politikës për të përfituar privilegje. Presioni ndaj gjyqësorit apo kategori të veçanta. Për të forcuar lirinë e medias që shpesh njihet me “pavarësinë editoriale” dhe për ti dhënë pavarësi profesionit të gazetarit ligji duhet të parashikojë rregulla në lidhje me kategoritë e lajmeve, transmetimet, llojin e programeve. Presioni ndaj nxjerrjes së disa shfaqjeve seksuale të disa përfaqësuesve politikë në Mbretërinë e bashkuar të Britanisë së madhe në vitin 1997 u konsideruar si shantazh i përdorur nga pronarët e medias për një ligj më favorizues³⁴.
- Marrëdhënia e shoqërisë me të punësuarit e saj. Vendet aplikojnë në përgjithësi kodin etik të gazetarit për të shmangur abuzimet që mundet të vijnë si pasojë e presionit për karrierë në shoqëri por dhe për arsye individuale të gazetarëve. Këto abuzime mundet të deformojnë tregun, të bërit biznes, konkurrencën dhe më e rëndësishmja të drejtën e publikut për tu informuar. Kodi etik i gazetarit, është një mjet i mirë vet-rregullues i medias.

Referencat

Referencat pershkruhen si me poshte:

1. Artikuj

Doc. 11305 25 June 2007 Toëards decriminalisation of defamation

Commission staff working Document, Media pluralism in the Member States of the European Union {SEC(2007) 32}

The fourth state media” <http://ëëë.cultsock.ndirect.co.uk/MUHome/cshtml/media/4estate.html>

Michael McEwen, A Report to the CRTC Media Ownership; Rules Regulations and Practices in Selected Countries and Their Potential Relevance to Canada, Media Strategy Policy Limited, July 2007

Viktor Bondi, American decades 1930-1939, Gale Research Inc

Sheila Coronel, Corruption and the watchdog role of the news media

Ben Bagdikian. 1983. The Media Monopoly. Boston: Beacon Press.

33 Bullgaria, Estonia

34 Shih më shumë “the fourth state media” <http://ëëë.cultsock.ndirect.co.uk/MUHome/cshtml/media/4estate.html>

Brikena Kasmi

Hugo de Burgh. 2003. 'Kings without crowns? The re-emergence of investigative journalism in China.' *Media, Culture & Society*, 25:801-820.

Aymo Brunetti and Beatrice Weder. 2003. 'A free press is bad news for corruption.' *Journal of Public Economics*, 87 (7-8): 1801-1824.

Andras Sajo. 2003. 'From corruption to extortion: Conceptualization of post-communist corruption. In *Crime, Law and Social Change*

2. jurisprudenca gjyqësore:

GJEDNJ, OTTO-PREMIINGER-INSTITUT kundër AUSTRISË 20 Shtator 1994

GJEDNJ, ÇËSHTJA Vereinigung Demokratischer Osterreich Soldaten and GUBI kundër Austrisë 19 dhjetor 1994

GJEDNJ, ÇËSHTJA Oberschlick v. AUSTRIA 1 korrik 1997

GJEDNJ, ÇËSHTJA RADIO ABC v. AUSTRIA 20 tetor 1997

3. Legjislacion

Rekomandimi 1897 (2010);

Rekomandimi nr. R (99);

Rekomandimi nr. R (94) 13

Rekomandimi nr. R (2000) 23;

Rekomandimi nr. R (96) 10;

Rekomandimi nr. 2006/952/CE, datë 20 dhjetor 2006;

Rekomandimi i Komisionit europian, nr. 2009/625/CE, datë 20 gusht 2009;

Rekomandimi nr.98/560/CE, datë 24 shtator 1998; Direktiva nr. 2000/31/CE, datë 8 qershor 2000

Direktiva e Televizionit pa Kufinj e Bashkimit Europian ndryshuar nga: Direktiva e Parlamentit europian nr. 97/36/CE, datë 30 qershor 1997 "Për ndryshimin e direktivës nr.89/552/CEE, datë 3 tetor 1989; Direktiva e Parlamentit europian nr.2007/65/CE, datë 11 dhjetor 2007 "Për ndryshimin e direktivës nr.89/552/CEE" e quajtur ndryshe Direktiva e "Shërbimeve të medias audiovizuale pa kufinj"; Direktiva e Parlamentit europian nr. 97/36/CE, datë 30 qershor 1997 "Për ndryshimin e direktivës nr.89/552/CEE, datë 3 tetor 1989.

Direktiva e Këshillit europian nr.89/552/CEE, datë 3 tetor 1989

Shënim i Bardhë (White paper) mbi një politikë komunikimi evropiane (COM[2006]374

Rezolutë e parlamentit evropian mbi rrezikun e shkeljes, në EU dhe vecanërisht në Itali të lirirsë së shprehjes dhe të drejtës për informim (neni 11(2) i Kartës së Drejtave themelore) (2003/2237).

Rezolutë e parlamentit Europian mbi zbatimin e neneve 4 dhe 5 të Direktivës 89/552/EEC "Televizioni pa kufij", ndryshuar nga Direktiva 97/36/EC, për periudhën 2001_2002, A6-0202/2005

Rezoluta e Këshillit europian nr.94/C 181/02, datë 27 qershor 1994, "Për politikën komunitare në fushën e radiotransmetimit televiziv numeric".

Rezoluta e Këshillit europian nr. 95/C 247/01, datë 4 prill 1995, "Për kulturën dhe shërbimet "multimediale"".

Vendimi i Komisionit europian nr. 2009/336/CE, datë 20 prill 2009 "Për krijimin e Agjencisë ekzekutive për menaxhimin e politikës komunitare në fushën e edukimit audiovizual dhe të kulturës"

Vendimi i Parlamentit dhe Këshillit europian nr.1041/2009/CE, datë 21 tetor 2009 "Për hartimin e një programi bashkëpunimi audiovizual me profesionistët e vendeve të treta".

Ligji Nr. 8221, datë 14.5.1997 Për radion dhe televizionin public e privat në Republikën e Shqipërisë

Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 Për radion dhe televizionin public e privat në Republikën e Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 8655 date 31.07.2000, me ligjin nr. 8794 date 10.05.2001, me ligjin nr.9016 date 20.2.2003, me ligjin nr.9124 date 29.07.2003, me ligjin 9531 date 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, date 13.01.2007)

Kodi civil

Ligji 9901 datë 14.4.2008 "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Ligji nr. 97 datë 4.3.2013